



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KATERËT E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **20.05.2022 (e Premte)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama mungoj znj.Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e katërtën të rregullt të KPF-së për këtë vit! Desha të ju njoftoj se shumicën e aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së, përveç vendimit për varrezat në Kabash që është kthye i kundërligjshëm, ju njoftoj që kemi pas edhe mbledhje të komiteteve obligative që i kemi themelur në Kuvendi. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e kam një shqetësim sa i përket subvencioneve. E di si ka shku ngjarja. Ajo çka më shqetëson më së shumti, në faqen e Komunës së Vitisë, që kanë kërku një sqarim qytetarët me të drejtë, ku listën që e kanë qit në të janë të nënshkruar gjashtë persona, që është shkelje ligjore, sepse në komision duhet me qenë numër tek. Po çka më ka shqetësu mu, se zyrtar që ju kanë përgjigj në komente njerëzve, matrapaz, me një gjuhë fyese, e ku qytetarët kanë të drejtë me komentu edhe me ngrit si shqetësim, e ku zyrtari i Drejtorisë së Kulturës ka shkru komente aty, që unë nuk ju përgjigjem matrapazëve, e nëse nuk ju përgjigjesh nuk je i obliguar me shkru në faqe, sepse duhesh me ju përgjigj dikujt. Pasi e kemi prezent drejtoreshën e arsimit, po i thamë që, drejtoreshë, e din shqetësimin e fshatit Pozharan rreth punës së shkollës. Ne si këshill i prindërve, unë si administrator e kemi pas marr një nismë, e ku këta e kanë mbajt një takim me zëvendës ministrin, e ku unë për arsye familjare nuk kam mund të jem pjesë në atë takim dhe aty u është premtu, që puna do te fillon shumë shpejtë dhe do të punohet me intensitet të lartë, që në shtator me hy nxansat në shkollë. Mbasi dy ditë punëkryesi ka dal me punu me dy vetë, vetëm tre ditë ka punu.

znj.Fatbardha Emini: Edhe dje ka qenë me dy punëtorë, për çdo ditë jemi tu e monitoru dhe tu raportu në ministri, sepse shqetësimi i juaj është me vend, kanë kalua çdo limit edhe në aspektin ligjor edhe njerëzorë, çdo ditë i shkruaj menaxherit për këtë, sepse mu më kanë than që, me 15 korrik ka mu dorëzua shkolla, e unë këtë nuk po e shohë, e nuk po du me rrejt veten sepse nuk bëhet kjo. Kontraktuesi mjete financiare ka edhe çdo herë ka pas, sa që vjet në fund të vitit janë detyru me ja marr, me i qu me një projekt tjetër, se ky nuk i ka shpenzu. Fajtori është operatori ekonomik.

Illir Zuka: Ne prapë kemi kërku takim me ministrin, ata po donë me gjet fajtorin e mu merr me ta, ndërsa neve si Pozharan nuk na intereson fajtori, neve na intereson mu kry shkolla. Tash pasi që është Jakupi këtu, kërkoj që edhe ky me na ndihmu me deputet që i kemi, sepse edhe në takime që po na presin ata atje, sa mënyrë e mirë si po na presin, po qasja e qeverisë ndaj këshillit të fshatit, këshillit të prindërve është jashtëzonisht keq. Gjene fajtorin, paditne, ata nuk po kërkoj me bë zgjidhje, ju e dini të gjithë se çfarë gjendje është aty në shkollën

në Pozharan.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Lidhje me komentet që i tha Iliri, nuk kam koment për këtë, më vjen keq për këtë, po nuk mujmë ta diskutojmë, ndërsa çështjen e shkollës e dimë ku janë kompetencat, po duhet me dhanë të gjithë gjithçka që me shty këtë.

z.Jakup Demiri: Ne si LVV kemi diskutu disa herë edhe me deputetët tonë, edhe me ministrin e arsimit, po problemi më i madh është tek kompania punëkryese, e kanë mbajtur takimin deputetët, po besoj që për shtator ka me qenë e gatshme me hi aty.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Shkolla e Pozharanit bashkon pozitë e opozitë, dilemë nuk ka, edhe projektet të mëdhaja gjithë duhet me na bashku. E kuptoj edhe pozitën e Jakupit, edhe ne hala bëjmë presion. Më kanë thanë a të ja ndërpre kontratën. Ama me ja ndërpre kontratën, me hi në procedurat e ritenderimit, zgjasin edhe më shumë se që po mendojmë që ky i kryen e unë nuk kam guxu me i thanë ndërpreje, sepse jam tut që po zgjat edhe më shumë. Kemi të bëjmë me një kompani jo serioze edhe pse shumë ka bërë presion kryetari e ish kryesuesi, gjendjen e kemi shumë të keqe në shkollën në Pozharan. Po ju thamë që aty ku ki nevojë për nënkryetarin e kryesuesin, na ki aty çfarë do qoftë.

znj.Fatbardha Emini, drejtoreshë: Problemi edhe më i madh ka me qenë i shkollës së mesme prej muajit shtator, që unë e kam ngritur në ministri, se apert 1-5 mësohet po tek shkolla e mesme është shqetësuese, sepse është moshë madhore, ai nuk rri prej shtatorit aty, ka me hup norma e mësimdhënësve të shkollës së mesme prej shtatorit, sepse kanë me mbetë mësimdhënësit pa norma, e muret me ardh deri tek mbyllja e shkollës.

z.Ilir Zuka: Profesorët e shkollës së mesme në Pozharan tani kanë me pas problem me norë mësimore, sepse nuk ka me pas nxënës ma në shkollë, sepse kërkush nuk e qon fëmijën për 20 minuta ora mësimore.

z.Zyrafete Rama: Edhe për mu është shqetësuese, se në çfarë gjendje është shkolla në Pozharan. Kemi bërë pyetje tek prindit dhe fëmijët, vetëm kanë fillu me i qu fëmijët në shkolla tjera, nuk kanë me nejtë në shkollën në Pozharan. Vendim i këshillit të fshatit dhe të shkollës është që, prej muajit Shtator mos me fillu cikli i ultë në objektin e shkollës së mesme, kemi me fillu në objektin e vjetër apo qatë ku është duke u ndërtu.

z.Ilir Zuka: Hajde nimona, po e organizojmë një protestë të gjithë se bashku.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Ilir, ku të më kërkon aty më ki.

znj.Zejnepe Osmani: Edhe unë u bashkëngjitem shqetësimit të kolegut Ilir me rastin e ndarjes së subvencioneve të Drejtorisë së Kulturës, e ku KF “vllaznia” nuk ka marr subvencione dhe KF “Presing”.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Kryetari e ka themelur komisionin me i shqyrtu kërkesat e që me e nda në formë më të mirë të mundshme, e pas ankesave që i ka bërë KF “Vllaznia” dhe disa OJQ të tjerë, unë kam kontakt me disa anëtar të komisionit e të cilët kanë thanë që dy lëndë nuk i kemi shqyrtu, sepse nuk i kanë plotësuar kushtet sipas tyre. Dhe kryetari e ka bërë një komision për shqyrtim të ankesave, e të cilët sot më kanë njoftu që kanë konstatu shkelje procedurale, tu fillu nga fillimi dhe ka marr vendime për shfuqizimin e vendimit të komisionit të shkollës së parë dhe lëndë do të kthehet nga fillimi. D.m.th kemi punë në këtë drejtim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin – plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e shfuqizimit të vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fsh. Kabash, vendimi me Nr. 01-110/05-365 i datës 04.04.2022, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me Nr. 1987-2/22 e datës 29.04.2022.

6. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-maj 2022.

Ne kuadër të këtyre pikave, më kanë ardh edhe dy pika tjera si pika shtesë dhe kërkoj që t'i sjellni me kohë pikat e rendit të ditës.

znj.Majlina Ostergllava, drejtoreshë: Propozim vendim për emërimin e komisioni për parkingjet e qytetit. Duhet të bëhet ndryshim plotësimi i komisionit, sepse janë ndryshu anëtarët e kuvendit.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: E diskutova edhe me Fatlumin këtë pjesë, nuk e kemi te lista e pronave në shfrytëzim për këtë vit, mos po na del ana ligjore jo e ligjshme.

znj.Majlina Ostergllava, drejtoreshë: Ne e kemi pas marr vitin e kalum, e kemi pas fillu procedurën, mirëpo ishin zgjedhjet e mbetet në gjysmë, e tani besoj që nuk kemi problem me këtë.

z.Illir Zuka: Për çdo vit lista që duhet mu dhanë në shfrytëzim duhet me ardh çdo vit që me pas të drejtë që ato brenda listën me qenë. Unë e votoj, ama nuk ka qenë në listë për dhënien në shfrytëzim.

z.Jakup Demiri: A është në listën që e kemi miratu ne për këtë vit, sepse nëse nuk është në listë nuk e kalon ministria.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Po besoj që ka zbrazësi juridike, e cila mundet me kalu, se për shkak që momentin që e kemi qit propozim vendimin për dhënie në shpallje në ankand publik, kjo ka qenë në regjistër, e që u shpall i ligjshëm, e kemi hi në fazën e zgjedhjeve e jemi ndal.

z.Illir Zuka: Unë jam pro me votu, ama jam i bindur që ka me kthy ministria mbrapa këtë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Propozim vendimin për marrëveshjen e bashkëpunimit që e kemi ndërmjet Komunës së Vitisë dhe UBD, e kemi formu një komision për hartimin e hartave zonale, të cilat nuk mundemi me i be vetë, sepse po kërkohet edhe profesionalizmi në profile të cilët ne nuk i kemi. Megjithatë është një marrëveshje në mes komunës dhe UBD, që do të punon në aspektin profesional UBD. Vlerën e keni pa sa është, jemi në përfundim të planit zhvillimor komunal, besoj që në javën e ardhshme na vjen si përfundim, e po dojmë me fillu me harta zonale, sepse disa komuna i kanë përfund, prandaj çdo marrëveshje që sjellë me vete kosto buxhetore, duhet me kalu në kuvend. Prandaj kërkoj që ta dërgojmë në kuvend.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: A ka diskutim lidhur me këtë? Kjo marrëveshje ju vjen në kuvend. A jeni për miratimin e rendit të ditës me këto dy pika të rendit të ditës? Me votat e të gjithëve u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Vërejtje tek fjala ime në faqen nr. 3 edhe faqe Nr. 6.

z.Jakup Dmiri: Tek faqja nr. 4 vërejtje.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Me vërejtjet e dhëna e qes ne votim për miratim. Nga të gjithë u miratu procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin – plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale.

znj.Fatbardha Emini drejtoreshë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në takimin e fundit me ministren dhe me drejtorin e departamentit të shkollave profesionale, është kërku që të bëhet një unifikim i arsimit profesional, sepse në disa komuna është shkollë e mesme teknike e në disa shkollë profesionale. E në bazë të Ligjit mbi Arsimit dhe Aftësimin Profesional është Institucion i Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) dhe është kërku të bëhet unifikimi i emërimit të shkollave të mesme në bazë të Ligjit mbi Arsimit Profesional, andaj kërkoj që të emërohet Institucion i Arsimit dhe Aftësimin Profesional, “Januz Zejnullahu”.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kisha hap diskutimin te anëtarët e komitetit në lidhje me këtë pikë. Vetëm shikoe mirë drejtoreshë, a duhet me qenë kështu Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP). Konsultohu edhe njëherë me ministrinë.

znj.Fatbardha Emini drejtoreshë: Unë prapë do të konsultohem me ministrinë, po kështu na kanë thanë neve, duhet me qenë Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP). Tash po e shoh edhe në ligj, që duhet me qenë kështu, po si do që të jetë, do të konsultohem edhe njëherë me ministrinë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të shkon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Me votat e të gjithëve shkon në kuvend.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011

z.Fatlum Demiri, kryetar i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Bazuar në vendimet e Kuvendit Komunal të Vitisë, me të cilët është miratu iniciativa e kryetarit për ndryshim plotësim të statutit, bazuar në vendimin për themelimin e komisionit, ne si komision kemi marr veprimet konform udhëzimeve administrative, kemi organizu konsultimet publike, i cili konsultim është mbajtur me datën 06.05.2022, ku kam pas një kërkesë nga një koleg për ndryshim plotësim, edhe në konsultim publik kemi pas një kërkesë. Ne si komision i kemi aprovu kërkesat e komisioni ka bërë disa rekomandime që i kemi paratë nevojshme. Unë para juve ju kam dergu nenet e statutit bazë, edhe nenet që ndryshohen e plotësohet. Më shumë nuk po ju marr kohë, jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Tek neni i parë, neni 13, paragrafi 13.3, për themelimin e këshillave të fshatrave. Ne kemi pas një punëtor dy ditore, të Shtunën dhe të Dielën, ku kemi pas trajnim me ish avokatin e popullit Elmi Jashari, edhe një ndër temat kryesore ne si administrator që nuk e kemi marr ata që na takon me udhëzim administrativ, që është kompensimi për gjashtë mbledhje, është obligim i komunës. Unë kërkoj nga Fatlumi, që në statut të futet edhe kompensimi për administratoret e fshatrave, edhe Elmi Jashari tha, duhet me qenë në statut kjo. E pati edhe ai një kërkesë, tha, kërkon, ose ne te kundërtën merrni avokat edhe kërkon kompensimin, sepse ju takon. Po mendoj që duhet mu shtu edhe kjo pikë që të bëhet kompensimi për kryetarët e fshatrave.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Në aspektin profesional, tek statuti nuk njihet askund pagesa. Duhet me thanë: çështja e pagesës së kryetarëve të këshillave të fshatit do të rregullohet me rregullore të veçantë.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Ne e kemi miratu vitin e kaluar rregulloren për këshillat e fshatrave. Aty është e përcaktuar edhe pagesa e kryetarëve të këshillave të fshatrave. Mendimi im është që, në statut nuk hynë çështja e pagesave, në statut nuk përmenden pagesat, ju me gjykatë e nxjerrni pagesën bazuar në rregulloren për këshillat e fshatrave. Unë tek Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, shumë komuna e kanë turizëm, nuk është përmend kerkund. Tu e pas parasysh që, Komuna e Vitisë ka vende të turizmit, mendoj që duhet me qenë tek Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

z.Jakup Demiri: Tek turizmi, edhe unë mendoj që duhet me qenë dikun. A duhet me qenë tek Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik apo jo, ama me rëndësi dikun duhet me qenë turizmi.

z.Fatlum Demiri: Kryesues, këto propozime jepen edhe në kuvend. Nëse miratohen në kuvend, unë i inkorporoj në ndryshim plotësim të statutit, edhe e dërgojmë në MAPL ashtu siç miratohet në kuvend.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është një plan që e ka përgatit Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport. Hapi debat nëse ka me diskutu. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të peste të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e shfuqizimit të vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash, vendimi me Nr. 01-110/05-365, i datës 04.04.2022, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me Nr. 1987-2/22, e datës 29.04.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky vendim është kthu nga ministria, sepse në certifikatën e pronës shënon që është lum, e ku lumi s'mund bëhet vend për varreza. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ramadan Deliu: Çka muj me bë na tashti, ne e dimë që ai vend nuk është Lum, as nuk ka qenë asnjëherë Lum.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Duhet Drejtoria e Katastri me ndërhy me ndryshu aty që s'është lum.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Duhet mu bë një korigjim katastral, sepse aty shkruan lum. Drejtoria duhet në aspekt profesional me marr veprimin. Duhet me pas kujdes këtu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pronat që jepen për varreza, nuk duhet me hi në listën e pronave në shfrytëzim.

z.Jakup Demiri: Nëse është në listën kadastrale lum, ne për këtë nuk e kemi votu atë ditë këtë propozim vendim, sepse nuk lejohet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Informatë mbi punën e komiteve funksionale për periudhën janar-maj 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo është një informatë bazuar në planin e punës së kuvendit komunal. Nëse keni pyetje shtesë, urdhëroni, nëse jo e qes ne votim për miratim që të shkon në kuvend. Me votat e të gjithëve shkon për kuvend edhe kjo pikë.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për ndryshim plotësim të vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me Nr.01-110/05-100, i datës 01.03.2022

z.Bekim Azizi, kryesues: Diskutim për këtë pikë. Tani hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Propozim vendim për miratimin e draft marrëveshjes ndërmjet Komunës së Vitisë dhe UBD

z.Bekim Azizi, kryesues: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

z.Bekim Azizi, kryesues: Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPF-së. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi**